



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 1 QERSHOR 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
NËNKRYETARJA E KUVENDIT
ERMONELA FELAJ

(Seanca filloi në orën 13:00)

Rendi i ditës:

1. Fjala e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Ermonela Felaj (Valikaj)
2. Fjala përshëndetëse e Presidentes së Republikës së Hungarisë, Shkëlqesisë së Saj, zonjës Katalin Novák.

Ermonela Felaj – Përshëndetje, kolegë!

Sikundër edhe jeni njoftuar, e zhvillojmë sot këtë seancë plenare të posaçme në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sepse kemi midis nesh një personalitet të shquar dhe një mike të nderuar, Presidenten e Republikës së Hungarisë, Shkëlqesinë e Saj, zonjën Katalin Novák.

Presidentja Katalin Novák do të përshëndesë Kuvendin e Shqipërisë, dhe për këtë arsye ju ftoj të gjithëve ta mirëpresim me një duartrokitje Shkëlqesinë e Saj, zonjën Katalin Novák, dhe njëkohësisht t'i urojmë mirëseardhjen!

Shkëlqesia Juaj, zonja Presidente Novák,
Të nderuar shkëlqesi ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik,

Të nderuara kolege e kolegë deputetë,

Zonja e zotërinj,

Kam kënaqësinë t'i uroj mirëseardhjen në Kuvendin e Shqipërisë Shkëlqesisë së Saj, zonjës Katalin Novák, Presidente e Republikës së Hungarisë!

Presidentja Novák është një mike e nderuar e Shqipërisë dhe shqiptarëve, një politikane e shquar në vendin e saj, me një karrierë të spikatur në shoqërinë civile, në qeverisje dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Si aktiviste, si qeveritare dhe si parlamentare, ajo është dalluar për vendosmërinë e saj në mbrojtje veçanërisht të çështjeve që lidhen me familjen, me gratë dhe me fëmijët.

Më 10 maj të vitit 2022 zonja Novák u zgjodh si kryetare e shtetit, Presidente e Republikës së Hungarisë. Për të parën herë, në këtë pozicion kaq të rëndësishëm u zgjodh një grua, e re në moshë, çka është diçka realisht shumë e rëndësishme dhe një privilegj, besoj, që mund t'i jepet kujtdo politikani gjatë jetës së tij politike.

Edhe në detyrën shtetërore më të lartë, Presidentja Novák nisët nga vizioni se vlera më e rëndësishme është të jetojmë jetën me bindjen dhe besimin që këto dy vlera duhet të na udhëheqin në punën tonë.

Unë fola më herët me Presidenten Novák, dhe kuptova që familja ishte veçanërisht e rëndësishme për të, edhe si Presidente.

Hungaria është një vend mik i Shqipërisë dhe marrëdhëniet tona diplomatike vitin e kaluar hynë në shekullin e dytë. Dialogu politik dhe bashkëpunimi i gjithanshëm mes dy vendeve tona duhet thënë se ka ardhur në rritje.

Ne i jemi mirënjohës Republikës së Hungarisë për mbështetjen e fuqishme në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë, si dhe për kontributin e mbështetjen që ky vend ka dhënë edhe në kuadrin e grupit të vendeve të Vishegradit.

Shqipëria dhe Hungaria janë partnere të besueshëm të NATO-s, edhe në përpjekjet e përbashkëta për zhvillimin, sigurinë, paqen dhe stabilitetin në rajon, në kontinent e më gjerë. Në këto marrëdhënie, pa dyshim, është edhe kontributi i Presidentes Novák, për të cilën, në emër të Kuvendit të Shqipërisë dua të shpreh mirënjohjen më të thellë!

Zonja dhe zotërinj,

Ftoj Shkëlqesinë e Saj, zonjën Katalin Novák, Presidente e Republikës së Hungarisë, të mbajë fjalën e saj përshëndetëse në Kuvendin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Katalin Novák – Të nderuar deputetë,

Të nderuar miq edhe të ftuar,

Në radhë të parë, faleminderit për mundësinë që më dhatë të flas në Kuvendin e Shqipërisë!

Është hera e parë që vij në Tiranë dhe në Shqipëri, dhe ndihem shumë e nderuar që, si Presidente e kombit, të jem në një vizitë zyrtare në Shqipëri.

Jam shumë e lumtur që mund të kem një marrëdhënie të mirë me Presidentin tuaj, me të cilin kemi pasur një bisedë shumë të frytshme.

E falënderoj zonjën zëvendëskryetare për prezantimin!

Doja të shtoja edhe diçka: jo vetëm si grua mund të jem për herë të parë në pozitën e Presidentes, por jam edhe si nëna e tre fëmijëve, që për mua është profesioni më i rëndësishëm në jetën time. I jam shumë mirënjohëse Zotit, që tri herë më ka dhënë mundësinë të sjell në jetë fëmijë, që i kemi rritur së bashku me bashkëshortin!

Për mua është shumë e rëndësishme vizita e sotme në Tiranë, sepse do të përpiqem të bëj sa më shumë si Presidente për marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve. Një fushë e rëndësishme e këtyre marrëdhënieve diplomatike është marrëdhënia me kombet e Ballkanit Perëndimor. Ndër to, një vend shumë i rëndësishëm është Shqipëria, me të cilën kemi një marrëdhënie të gjatë historike miqësore. Jo vetëm liderët e të dyja kombeve, por edhe popujt tanë e respektojnë, e mirëkuptojnë dhe e mbështesin njëri-tjetrin.

Në Hungari kam punuar 8 vjet për familjet hungareze, dhe kjo është një fushë për të cilën duhet të punoj shumë edhe si Presidente e vendit. Për 4 vjet kam qenë deputete në parlamentin e Hungarisë, ndaj mund ta kuptoj edhe bukurinë e punës suaj, pasi nuk ka punë më të mirë se të jesh përfaqësues i votuesve.

Kam ardhur në Shqipëri në një kohë kritike, kur Europa është në rrezik, pasi po përballet me vështirësi me të cilat nuk është përballet prej kohësh, ku ndër to dua të theksoj: së pari, luftën në Ukrainë dhe pasojat e saj; së dyti, paqen, stabilitetin dhe rëndësinë e tyre për Ballkanin Perëndimor; së treti, rritjen e vazhdueshme të presionit të emigracionit ilegal; së katërti, sfidat demografike me të cilat duhet të përballemi më fort se ndonjëherë në histori; së pesti, nga këto që përmenda më sipër, fuqia politike botërore e

Europës është në pikëpyetje: në çfarë vendi mund të jetë Europa në politikën botërore?

Në radhë të parë, dua të flas për luftën në Ukrainë. Të gjithë jemi të habitur me atë që po ndodh në Ukrainë. Vendimi i Rusisë para një viti për të sulmuar fqinjën e tij, na ka vendosur në një situatë të re. Ne jemi pranë Ukrainës dhe e mbështesim sovranitetin dhe integritetin territorial të saj, gjithashtu, i mbështesim të gjithë refugjatët nga lufta në Ukrainë. Këtu dua të përmend se, si fqinjë të drejtpërdrejtë të Ukrainës, deri tani kemi ndihmuar 2 milionë refugjatë ukrainas, një numër shumë i madh për një komb prej 10 milionë banorësh, edhe pse shumica e tyre nuk kanë qëndruar për një kohë të gjatë në Hungari. Ne jemi aty ku duhet të japim ndihmë humanitare, e mbështesim sfidën e Ukrainës dhe jam e bindur që lufta duhet të mbarojë sa më shpejt. Duhet të gjejmë rrugën për armëpushim, që të arrijmë paqen. Në vend të luftërave, kemi nevojë për armëpushim; në vend të armëve, kemi nevojë për bisedime; në vend të refugjatëve, duam t'i shohim familjet bashkë, dhe në vend të të vdekurve, duam të shohim lindje të reja. Pra, në Ukrainë duam të shohim armëpushimin dhe rrugën drejt paqes, sepse çdo luftë ka vetëm humbës dhe zgjidhja është gjithmonë paqja. Lufta shkakton shumë humbje jetësh, përveç kësaj shohim inflacionin, rritjen e energjisë elektrike, pasojat ekonomike, të cilat po i vuajnë të gjithë njerëzit në Europë, shohim frikën dhe nuk shohim stabilitet në sytë e njerëzve të Europës. Çdo njeri ka frikë se kjo luftë shkon deri në kombin e tij, ndaj është shumë e rëndësishme të gjejmë rrugën drejt paqes dhe palët të ulen në tavolinë dhe të bisedojnë.

Së dyti, kam përmendur paqen dhe stabilitetin, rëndësinë e tyre për Ballkanin Perëndimor. Të gjithë shohim Ukrainën, por harrojmë sa e rëndësishme është të ketë paqe dhe siguri në Ballkanin Perëndimor. Po të shohim Kosovën apo Bosnjën dhe Hercegovinën, do të vëmë re se sa e vështirë është situata dhe sa pak duhet për të rritur tensionin, që kjo pastaj të kalojë edhe në nivel lufte. Ndaj është shumë e rëndësishme për ne, që të ruajmë paqen dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor.

Në Kosovë kemi ushtarë hungarezë, gjithashtu; në KFOR kemi mbi 400 ushtarë, 20 prej të cilëve janë lënduar nga sulmet e fundit dhe shumica e tyre janë në spital. Situata mund të

kalojë në agresion dhe këtë duam ta shmangim në çfarëdo mënyre.

Jam e bindur se çelësi i stabilitetit të Ballkanit Perëndimor është integrimi evropian. Po ashtu, jam e bindur se integrimi evropian do të na çojë drejt paqes dhe stabilitetit në të gjithë Europën, sepse paqja dhe siguria e Europës varet shumë nga Ballkani Perëndimor. Kemi nevojë sa më shpejt për t'u integruar në Europë. Prandaj e mbështesim integrimin e Shqipërisë në BE dhe për këtë japim edhe ndihmën tonë. Duam që ju shqiptarët t'ju përshëndesim si qytetarë të BE-së, pasi jo vetëm ju keni nevojë për BE-në, por edhe ne hungarezët, gjithashtu, edhe kombet e BE-së kemi nevojë për ju brenda BE-së.

Së treti, përmenda emigracionin ilegal, i cili është një problem në rritje për Europën. Ne duhet të bëjmë çdo gjë për ta ndaluar emigracionin ilegal, që t'ua bëjmë të pamundur atyre që i çojnë njerëzit në mënyrë ilegale nga një vend në një tjetër, ta ndalojmë këtë tendencë dhe të mbështesim njëri-tjetrin.

Së katërti, fola në lidhje me demografinë e familjeve. Çdo vit e më pak fëmijë po lindin në Europë. Në çdo komb evropian është problem që nuk ka mjaftueshëm fëmijë. E di që edhe këtu në Shqipëri është ulur numri i martesave dhe është rritur numri i divorceve dhe po lindin gjithnjë e më pak fëmijë. Edhe në Hungari jemi përballur me probleme të tilla dhe ne kemi dhënë një përgjigje me në qendër familjen: ne besojmë në vlerat e familjeve tradicionale dhe besojmë se forcimi i këtyre vlerave sjell zgjidhje për këto probleme. Ne besojmë se, edhe nëpërmjet pozitës suaj si deputetë, mund të ndihmojmë në këtë aspekt.

Së fundi, pyetja është: çfarë peshe do të ketë Europa në të ardhmen, në kuptimin global; sa mund ta forcojë Europa peshën ekonomike, demografike në botë? Unë shoh se e ardhmja do të jetë e errët. Nëse nuk do të japim përgjigje të sakta për këto probleme, kemi frikë se Europa do të mbetet poshtë në këtë sfidë globale dhe se pozita që ka aktualisht, do të humbasë. Zgjidhja mund të jetë që ta gjejmë dhe ta mbajmë rrugën drejt paqes, sigurisë dhe stabilitetit.

Shqipëria është pjesë e Europës. Ne duam që Shqipëria të jetë zyrtarisht pjesë e Europës, sa më shpejt. Ne kemi nevojë për Shqipërinë brenda BE-së dhe ju mbështesim, siç mbështesnin dikur njëri-tjetrin Skënderbeu dhe Huniadi.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju uroj punë të mbarë!

Ermonela Felaj – Shumë faleminderit sërish, e nderuar Shkëlqesia Juaj, zonja Presidente, për të gjitha fjalët dhe mesazhet që ndatë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë!

Është e vërtetë, e diskutuam edhe më herët, që rrënjët e miqësisë sonë janë shumë të thella, shkojnë realisht shumë thellë në histori, deri në shekullin XV, ndaj është e rëndësishme që këto vlera të miqësisë t'i shfrytëzojmë për më të mirën e dy popujve tanë, duke premtuar që parlamentet e të dyja vendeve, natyrisht, qenia

dhe prezenca juaj si kryetare e shtetit në Republikën e Hungarisë, do të ndihmojnë për forcimin e kësaj miqësie mes nesh, si dhe do të ndikojnë njëkohësisht edhe për paqen në të gjithë rajonin tonë.

Ju faleminderit, kolegë!

Më lejoni që, në mbyllje të kësaj seance të posaçme, dhe në nder të Presidentes së Hungarisë, ta shoqëroj zonjën Presidente deri në dalje.

Ju faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 13:30)

Nënkryetarja e Kuvendit

Ermonela Felaj

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**